




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Punëjeto/Prodato Received/Delivered	05.08.2022	2	viti god year
Organ /Hjesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/CHW	4576/2022		1/3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.613/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtar, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.1931/2021 të datës 29.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.613/2021 të datës 06.07.2021, të parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_ përmes përfaqësueses me autorizim avokates \_\_\_\_\_ me adresë \_\_\_\_\_

kundër organit të punësimit/Policia e Kosovës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 05.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.613/2021 të datës 06.07.2021 të parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_

A r s y e t i m

Ankuesja \_\_\_\_\_ e punësuar në Policinë e Kosovës me datë 06.07.2021 përmes përfaqësueses me autorizim ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 3473/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër përgjigjes/njoftimit të datës 01.06.2021 të pranuar me datën 04.06.2021 si dhe vendimit të Komisionit të ankesave të Policisë brenda Drejtorisë së Përgjithshmen të Policisë me numër 03/02-842 të pranuar me datën 02.07.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 07.07.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Policinë e Kosovës. Ndërsa Këshilli, me datë 15.07.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.



Këshilli në mungesë të kuorumit për vendosje nuk ka mundur të shqyrtoj ankesën e ankueses dhe e njëjta përmes shkresës me numër protokollit 4278/2021 të datës 19.08.2021 është udhëzuar për ushtrimin e mjeteve juridike në pajtim me dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr.1931/2021 të datës 29.06.2022 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ka detyruar Këshillin që të shqyrtoj dhe të vendos për ankesën A.nr.613/2021 të datës 06.07.2021.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Aktgjykimin A.nr.1931/2021 të datës 29.06.2022; Ankesën me numër protokollit 3473/2021 të datës 06.07.2021 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesa e datës 14.05.2021 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë në Prishtinë; Përgjigja në kërkesë me numër Reference 07/1-01/052 të datës 01.06.2021 për shpërblimin e një page mujore, si dhe shujtës ditore; Vendimin me Nr.731-KA-2021 të datës 30.06.2021 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Autorizimin e datës 14.05.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 3532/2021 të datës 07.07.2021; Përgjigjen në kërkesë me numër të protokollit 3747/2021 të datës 15.07.2021; Kontratën e punës për kohë të pa caktuar me numër reference 07/1-01A/0315 të datës 19.08.2014; Përshkrimin e detyrave të punës për ankuesen Njoftimin e lëshuar nga Policia e Kosovës lidhur me kërkesën e datës 14.05.2021; Ankesën me numër 731-KA-2021; Emalin zyrtar të datës 22.04.2021 të H.H drejtuar F.A; Emalin zyrtar të datës 20.04.2021 të F.A drejtuar H.H; Emalin zyrtar të datës 18.02.2021 tw F.A drejtuar D.D; Emalin zyrtar të datës 09.02.2021 të F.A drejtuar F.Z; Emalin zyrtar të datës 11.01.2021 të F.Z drejtuar S.N.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke vepruar sipas Aktgjykimit A.nr.1931/2021 të datës 29.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative dhe pas analizimit të provave materiale të çështjes ka gjetur se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesja është e punësuar në Policinë e Kosovës dhe se e njëjta sipas kontratës së punës me numër 07/1-01A/0315 të datës 19.08.2014 ushtron pozitën "Pastruese", në Drejtorinë Rajonale në Gjilan.

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë:* 6. *Nëpunës administrativoteknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike dhe si rrjedhojë duke u bazuar në përshkrimin e detyrave të punës të ankueses, Kolegji ka konstatuar se pozita "pastruese" hynë në kategorinë e nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetëse respektivisht ankuesja nuk ka statusin e nëpunësit të shërbimit civil, andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të*



Kosovës, ku përcaktohet së Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidateve për pranim në Shërbim Civil, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.613/2022 të datës 06.07.2021 të parashtruar nga ankuesja

Kolegji i Këshillit në kuptim të nenin 82 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë konstaton se marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës, andaj, ashtu siç është përcaktuar me nenin 24 paragrafi 4 të të njëjtit ligj, Kolegji i Këshillit udhëzon palën ankuese se fillimisht ka të drejtë ankesën të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.613/2021

**Ilire Mehmeti-SHAQIRI**

*Ilire Mehmeti*  
Procesmbajtëse

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

*Ardita Haxhnikaj*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësueses me autorizim, avokates
- Drejtorit të Përgjithshëm në Policinë e Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

